



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më _____.____.2023

Procesverbal -Tipi i kontrates -Shërbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS -“Investime ne fondinpyjor”

LLOJI PROÇEDURËS- “Proçedurë e hapur – Shërbim”

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - 10.829.896 (dhjetëmilion e tetëqind e njëzet e nëntëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë pa t.v.sh.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):77231600-4 - Shërbimetëpyllëzimit,

Ne bazetenenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhenenit 78, pika 2, të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullaveteprokurimitpublik”, autoritetikontrator Bashkia Elbasan kahartuarprocesverbalin per argumentimindhemitatimin e kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjensi me poshte:

Shtojca 8

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a)është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b)nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c)nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç)personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d)nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e)ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f)nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Formulari i ofertes, sipas shtojcës 1;*

c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a dhe b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Pika c) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit te prokuruar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqese vërtetimin per taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cilin vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar sipas parapublikimit nën joftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Argumentimi: Kriteri **2.2.1** është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe referuar nënienit 43 dhe nënienit 47 VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”. Duke marrë në konsideratë shërbimin objekt prokurimi, afatin e kontratës dhe eksperiencat e mëparshme nga AK kërkohet që OE ofertues të paraqesin vërtetime se disponojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kriteri **2.2.2** është vendosur referuar nënienit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” si dhe Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Argumentimi: Kriteri **2.2.3** është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistimin e taksave vendore” indryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, shumat dhe shërbimet e realizuara

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 41 pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 - Nëse operatori ekonomik është subjekt prodhues/tregtues i fidaneve pyjorë duhet të jetë i pajisur me Liçence Profesionale Kodi II 4 (Për prodhim ose tregëtim të farërave dhe fidaneve) leshuar nga QKL. Operatori duhet të deklarojë se ka gjendje fidanet e kërkuar në përputhje me specifikimet teknike. Deklarata duhet të shoqërohet me certifikatën fitosanitare të leshuar nga autoritetet shtetërore (Ministria e Bujqësisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në VKM-ne Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullave të tjera nenligjore të përbashkëta" e ndryshuar, për licencat e grupit të tretë. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin teknik

dhe profesional për realizimin e shërbimeve. Licenca e kërkuar është në përputhje me zerat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike. Certifikata fotosanitare është në përputhje me kërkesat e Ak për specifikimet teknike të fidaneve pasi nëpërmjet kësaj certificate autoriteti verifikon llojin e fidanit, moshën dhe cilësinë.

2.3.3 Nëse operatori ekonomik nuk është subjekt prodhues/tregëtues i fidanëve pyjorë duhet të paraqesë kontratë furnizimi me një subjekt prodhues/tregëtues të fidaneve pyjorë të licencuar me Liçencë Profesionale Kodi II 4 (Për prodhim ose tregëtim të farërave dhe fidaneve) leshuar nga QKL, në të cilën duhet të përcaktohet objekti, sasia, mosha dhe lloji i fidaneve pyjorë, si dhe të shoqërohet me certifikatën fitosanitare të leshuar nga autoritetet shtetërore (Ministria e Bujqësisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në VKM-ne Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullave të tjera nenligjore të përbashkëta" e ndryshuar, për licencat e grupit të tretë. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin teknik dhe profesional për realizimin e shërbimeve. Licenca e kërkuar është në përputhje me zerat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike. Certifikata fotosanitare është në përputhje me kërkesat e Ak për specifikimet teknike të fidaneve pasi nëpërmjet kësaj certificate autoriteti verifikon llojin e fidanit, moshën dhe cilësinë.

2.3.4 Operatorët ekonomikë për arsye verifikimi nga autoriteti kontraktor duhet të deklarojnë adresën e vendndodhjes së fidaneve.

2.3.5 - Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e mëposhtme :

- **SSH/EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me aktivitetin objekt prokurimi.**

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri **2.3.5** është vendosur në përputhje me Nenin 40 pika 6 gërma c të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar në nenin 79 të LPP.

Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me certifikatën e menaxhimit të cilësisë gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë të AK që ky OE do të ofertojë produkte të certifikuar të një cilësie të mirë e në përputhje me standartet ndërkombëtare të cilësisë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te disponojë **1 (nje) automjet të përshtatshëm për transport mallrash** me kapacitet mbajtes minamalisht 3.5 ton per te cilin duhet te paraqese dokumentat e meposhtem:

- **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**
- **Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit,** shoqëruar me dokumentacionin përkatës tëpronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publike (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi),çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të trete për ato mjete qe pajisen me leje transporti sipas legjislacionit ne fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.7- Nje punësim mesatar prej **17** (shtatëmbëdhjete) personave, për **3 muajt e fundit** të vërtetuar me;

- **Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse,në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;**
- **Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.**

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e punonjësve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane të këtij kriteri kërkohet që opertoret ekonomike të

deshmojnë që kanë fuqinë punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund të vihen.

Në vijim të rekomandimeve të dhëna nga APP-ja dhe kompleksitetit të shërbimit u analizuan zërat e preventivave (Pyllëzime, zëvendësime, shërbime kulturore), për kryerjen e shërbimit nga e cila rezultoi se numri i përcaktuar nga AK i punetoreve është i nevojshëm dhe shërben për kryerjen e këtij aktiviteti në të tre komponentët e tij.

2.3.8- Operatori duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontrate pune, Lejen Profesionale të ushtrimit të profesionit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për **3 mujorin e fundit**.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin drejtuesit teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri **2.3.9** është vendosur në bazë të pikës 4, tënenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Përmiratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operoret ekonomike të deshmojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Njesia Prokurimit